

DT 22/2/2023
N 82/7 PRO

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E RRETHIT GJYQËSOR
TIRANË

Nr. 868/79 rregj.them
Data e regjistrimit 09.06.2022

Nr. 5934/5 vendimi
Data e vendimit 16.02.2023

VENDIM

“Mbi depozitimimin e akteve në regjistrin e organizatave jofitimprurese”

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë e përbërë nga :

GJYQTARE: ANILA GURI (KRISTANI)

në cilësinë e gjyqtarit të vetëm, sot më date 16.02.2023 mora në shqyrtim aktet si më poshtë

KERKUES: Shoqata Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar (KOKSH), me adrese rruga “Muhamet Gjollështa”, sheshi “Mustafa Atatürk”, Tirane, përfaqësuar sipas autorizimit datë 08.06.2022 nga z.Gerti Shima.

OBJEKTI: Regjistrimin e vendimit Nr.26 date 28.05.2022 të Asambles se Pergjithshme të Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar (KOKSH).

BAZA LIGJORE: Kushtetuta e RSH-së, ligji nr.8788/2001, ligji 8789/2001, ligji 79/2017 i ndryshuar.

VEREN SE:

Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar (KOKSH) është organizatë shoqërore joqeveritare, jo fitimprurese, e regjistruar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë me vendim me nr.5934 datë 22.06.2018.

Me kërkesën drejtuar gjykatës kërkuesi ka kërkuar regjistrimin pranë regjistratit përkatës të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, të vendimit me Nr.26 date 28.05.2022 të marrë nga Asambjela e Pergjithshme e Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar.

Sipas procesverbalit të mbledhjes së Asambles së Pergjithshme datë 28.05.2022 rezultoi mbledhja e Asambles së Pergjithshme të Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar, është mbajtur me praninë e 55 anëtarëve me të drejtë vote, që refuzoi akteve rezultoi se ka qenë kuorumi i kërkuar prej 2/3 e anëtarëve lidhur me vendimet e marra.

Sipas përmbajtjes së vendimit të marrë dhe procesverbalit të mbajtur me rastin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar janë marrë në shqyrtim disa çështje lidhur me mbarëvajtjen e punës së kërkuesit si dhe janë marrë disa vendime dhe konkretisht është vendosur:

- Miratimi i auditimit të veprimtarisë nga një auditues i pavarur për vitet 2019, 2020, 2021.
- Miratimi i ndryshimeve të statutit sipas propozimeve të antarsisë.
- Miratimi i sportistit të zgjedhur nga Komisioni i Sportistëve për të qene anetar i Komitetit Ekzekutiv të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar
- Sportisti i zgjedhur nga Komisioni i Sportistëve më datë 14.04.2022 është z. Izmir Smajlaj.
- Miratimi i Rregullores së Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS).
- Ratifikimi i Projektit "Ekipe Sportive 2022", miratimi i buxhetit dhe strukturës së projektit.
- Pranimi i anetareve të rinj të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar.
 - Shoqata Kombëtare e Padelit
 - Federata Shqiptare e Ndeshjes së Lire.

Lidhur me ndryshimet statutores rezultojnë se bazuar në parashikimin e bërë nga neni 16 i ligjit nr.79/2017 "Për sportin", Ministri i Arsimit dhe Sportit ka dhënë miratimin e tij me urdhërin me nr.756 datë 29.12.2022, ku bashkëlidhur saj është përmbajtja e neëve të ndryshuara të statutit.

Rezultojnë se ka ndryshuar, pjesërisht përmbajtja e statutit dhe konkretisht është ndryshuar përmbajtja e neëve 2, 5, 10, 16, 19, 21, 23, 24, 26, 28 të statutit, ndryshime të cilat janë në përputhje me ligjin dhe me parashikimet statutores.

Gjykata pasi mori në shqyrtim tërësinë e akteve të paraqitura bashkëlidhur kërkesës, si dhe ato të paraqitura në plotësim të kërkesës të konstatuara nga gjykata, bazuar në parashikimet statutores mbi vendimmarrjen e Asamblesë së Përgjithshme, si dhe parashikimet e bëra në ligj vlerëson se kërkesa është e bazuar në prova dhe në ligj.

PER KETO ARSYE

Bazuar në Gjykata në baze të ligjit nr.8788 datë 07.05.2001 "Për organizatat jofitimprurëse", ligjit Nr.80/2021 "Për regjistrimin e organizatave jofitimprurëse";

VENDOSI

Pranimin e kërkesës.

Depozitim të proces-verbalit dhe vendimit të datës 28.05.2022 të mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar (KOKSH), me të cilin është vendosur:
"Miratimi i auditimit nga një auditues i pavarur për vitet 2019, 2020, 2021.

-Miratimi i ndryshimeve të statutit

-Miratimi i sportistit të zgjedhur nga Komisioni i Sportistëve për të qene anetar i Komitetit Ekzekutiv të Komitetit Olimpik Kombëtar Shqiptar. Sportisti i zgjedhur nga Komisioni i Sportistëve më datë 14.04.2022 është z. Izmir Smajlaj.

-Miratimi i Rregullores së Këshilli i Arbitrazhit Sportiv (KAS).

ndhjes së
vrtim
he

- Ratifikimi i Projektit "Ekipet Sportive 2022", miratimi i buxhetit dhe struktures se projektit.
- Pranimi i anetareve te rinj te të Komitetit Olimpik Kombetar Shqiptar .
- Shoqata Kombetare e Padelit
- Federata Shqiptare e Ndeshjes se Lire.

Depozitimim dokumentacionit dhe të gjitha akteve bashkëlidhur kërkesës pranë Zyrës së Rregjistrimit të Organizatave Jofitimpruese pranë Gjyqates se Rrethit Gjyqesor Tirane. Urdhërohet Zyra e Rregjistrimit të Organizatave Jofitimpruese pranë Gjyqates se Rrethit Gjyqesor Tirane të pasqyrojë në regjistër ndryshimet përkatëse.
U shpall më datë 16.02.2023.

**SEKRETARE
ESLA SEJDARASI**



**GJYQATARE
ANILA GURI (KRISTANI)**

